



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 20.07.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arton Brahim, Elmire Nikçi-Rexha, Nenad Miladinoviç, Tiera Kasumi - Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok, Mirsada Behluli dhe Faton Maroll.

Mungoi: Oktay Kurtesh.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Përfaqësuesit e KFOR-it, Klaudia Mula, koordinatore për komunitete nga ZKKK-ja, Meral Aygun, zyrtare e ZKKK-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komiteti për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë

R E N D D I T E:

1. Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelina Sahiti;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, z. Arbër Sadiki;
4. Raporti i ZKKK-së, për muajin qershor 2022;
5. Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë lidhur më gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
6. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua Rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Faqe 1 nga 6

Pika e dytë

Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelina Sahiti

Adelina Sahiti, drejtore tha se fokus i veçantë dhe rëndësi të veçantë në drejtorinë tonë kanë edhe komunitetet jo shumicë, si dhe përfaqësimi i tyre dhe përm bushja e nevojave dhe kërkesave që kanë komunitetet në Komunën e Prishtinës.

Na gëzon fakti që kemi edhe zyrën që merret pikërisht me komunitetet brenda Komunës së Prishtinës, për përbushjen e nevojave të tyre, në veçanti për arsim, shkollim dhe për hapësira rekreative, ku ne jemi të hapur të bashkëpunojmë dhe besoj se do të kemi bashkëpunim të mirë.

Sa për informacionin e juaj ne jemi të lidhur ngushtë me "Ndërmarrjen Publike Banesore", për ofrimin e hapësirave të kësaj ndërmarrjeje lokale për të ushtruar veprimtaritë e ndryshme përmes OJQ-vë, në Komunën e Prishtinës, ku në fokus janë personat më aftësi të kufizuara dhe shërbimet që u ofrohen atyre.

Mirëpo ne do të asistojmë që të tilla hapësira të ju jepen edhe komuniteteve tjera pa dallim të përfaqësuara në Komunën e Prishtinës.

Nenad Miladinoviç, tha se lidhur me bashkëpunimin e Komitetit për Komunitete dhe Drejtorinë së Mirëqenies Sociale, duke u nisur nga përvoja që kamë në këtë komitet dhe kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë, ku këtë bashkëpunim e kemi arritur përmes ZKKK-së.

Kemi arritur të sigurojmë dru për ngrohje, pako ushqimore dhe pako higjenike për familjet skamnore, besoj së ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Adelina Sahiti, drejtore tha se sa u përket druve për ngrohje ne e kemi një shumë të druve që aktualisht është propozuar që t'i marrim dhe t'i shpérndajmë tek të gjitha familjet skamnore pa dallim, mirëpo jemi duke pritur përgjigjen nga drejtori i Drejtorisë së Inspektionit z. Dushi së a është në rregull në aspektin ligor që ne t'i marrim këto dru dhe t'i shpérndajmë tek familjet që kanë nevojë.

Ajo në vazhdim tha se që sot do të takohem me z. Dushi se si të procedojmë tutje dhe mos të na zë nëntori apo dhjetori që këto familje të mbeten pa u furnizuar me dru.

Nenad Miladinoviç, tha se lidhur më shpérndarjen e ndihmave duhet pasur shumë kujdes së kujt po i ndahen këto ndihma, sepse herën e kaluar kemi pasur disa gabime teknike si nga ana e juaj ashtu edhe nga e jona familjet skamnore kanë mbetur pa ndihma financiare dhe ju lutem në të ardhmen të keni kujdes mos të mbeten pa ndihma familjet që kanë nevojë.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se po i lutem drejtore që në të ardhmen nëse ndonjë zyrtar i drejtorisë përkatëse vëren ndonjë gabim apo ndoshta xhirollogaria nuk është në rregull të informoj Komitetin për Komunitete dhe ZKKK-në.

Ajo ju drejtua edhe përfaqësuesve të komuniteteve që të kenë kujdes gjatë hartimit të listave dhe xhirollogarive, sepse aty bëhen më së shumti gabime.

Kimeta Shok, tha se a ka mundësi drejtore që të u ndahan ndihma edhe personave që janë të sëmurë nga kanceri.

Adelina Sahiti, drejtore tha së kemi pasur pyetje të tilla dhe normalisht që ne ju ofrojmë një shumë solide, mirëpo më këto raste kryesisht merret Drejtoria e Shëndetësisë, ku mund të shkoni dhe të informoheni më gjerësisht ata gjenden në katin e dytë në Komunën e Prishtinës.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se e falënderoi drejtoren për informatat e dhëna, mirëpo në vazhdim shtroi pyetje se kush ka të drejtë të marr ndihma sociale.

Adelina Sahiti, drejtore tha se lidhur me diskutimin e znj. Behluli në kuadër të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, funksionon edhe Qendra për Punë Sociale, ku mundë të informoheni mbi të gjitha çka ju intereson lidhur më ndihmat.

Janë tri njësi aktuale në Komunën e Prishtinës, që merren më këto punë, është Qendra kryesore tek Qafa, tjetra është në Bregun e Diellit, si dhe ajo në Kodrën e Trimave të cilat janë funksionale pesë ditë në javë, ku në të tri njësitë është komisioni i cili del në terren për verifikim të situatës.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se në bashkësinë boshnjake kemi dy raste, është fjala për dy gra të komunitetit boshnjak ku njëra prej tyre është e ve dhe ka mbetur pa punë në moshën 62 vjeçare, dhe tjetra më shtatë fëmijë është e moshës 68 vjeçare, si mundemi me i ndihmuar.

Adelina Sahiti, drejtore tha se ne si drejtori këto raste i subvencionojmë me pagesën e qirasë, ndërsa për djalin e saj, ai mund të vijë në drejtori dhe të aplikoj për ndihmë, ku për këto raste merret komisioni i cili e bënë vlerësimin e gjithë dokumentacionit të ofruar, pastaj dalin në terren dhe e verifikojnë gjendjen faktike.

Klaudia Mula, kërkoi të dijë nga drejtorja, se a ka në plan program diçka për prindin vet ushqyes dhe për nënrat vet ushqyese në këtë rast.

Adelina Sahiti, drejtore tha se ne në prioritet i kemi edhe prindërit vet ushqyes e në veçanti nënrat në këtë rast ku i kanë vështirësitë më të mëdha.

Ne jemi duke punuar dhe jemi në prag të realizimit të një marrëveshje, mirëpo për shkak të disa komenteve që i kemi marr nga Zyra ligjore ka rezultuar së nuk kanë qenë në harmoni me ligjin, prandaj dhe ne jemi duke e modifikuar atë marrëveshje dhe shumë shpejt do ta hedhim për votim në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, z. Arbër Sadiki

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se, ftesës së komitetit, që z. Arbër Sadiki të merr pjesë në mbledhjen e komitetit, ai nuk ju ka përgjigjur.

Nenad Miladinoviç tha se është më se e nevojshme që drejtori i drejtorisë përkatëse të vjen në takim, pasi që është në pyetje procesi i legalizimit, ku konkretisht në Bërnicë të poshtme kemi pasur mbi 90% të kërkesave që janë dorëzuar për legalizim, prandaj na intereson se çka është bërë me ato kërkesa.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se znj. Elmire, anëtare e Kuvendit, do i përcjell rekomandimet e komitetit për në Kuvendin e Komunës.

Pika e katërt

Raporti i ZKKK-së, për muajin qershor 2022

Klaudia Mula, tha se sa i përket Raportit të ZKKK-së, për muajin qershor 2022, çdo herë raporti vjen me kohë në të dy gjuhët, ku besoj se e keni lexuar të gjithë, nëse keni diçka me pyet jam e gatshme të ju përgjigjem.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se sa i përket Raportit të ZKKK-së, për muajin qershor 2022, raporti është shumë i mirë dhe se janë të përfshira të gjitha informatat e rëndësishme. Duke iu drejtar përfaqësuesve të Komitetit se, a i kanë dërguar emrat e të interesuarve për punë tha se nëse nuk i kanë dërguar duhet t'i dërgojnë tek Klaudia qysh kishte me i përcjell në Zyrën për komunitete pranë Kryeministratit.

Ajo në vazhdim shtroi pyetje lidhur me trajnimet të cilat organizohen nga Komuna se a ka mundësi të informohemi lidhur me atë drejtim.

Klaudia Mula, tha se lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Behluli ende nuk kemi zhvilluar takim me koordinatorin e zyrës për çështjen e komuniteteve pranë Kryeministratit.

Pika e pestë

Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë lidhur më gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre

Mirsada Behluli, kryesuese, tha se sa i përket gjendjes së sigurisë në bashkësinë tonë nuk kemi kurrrfarë problemesh.

Kimeta Shok, tha se as në bashkësinë tonë nuk kemi probleme, vetëm se na mbetet të shikojmë se çka do të bëhet me regjistrimin e fëmijëve në fakultete, pasi që edhe regjistrimi ka filluar vonë.

Faton Marolli, tha se sa i përket çështjes së sigurisë nuk kemi probleme, mirëpo dua të ndërlidhem me diskutimin e znj. Shok. Unë si përfaqësues i komunitetit ashkali, përmes Drejtorisë së Administratës, jam njoftuar se asnje Bashkësi Lokale, nuk guxon më lëshuar vërtetim pa u pyetur përfaqësuesi i cilit do komunitet se a është më të vërtetë ai person i atij komuniteti.

Nenad Miladinoviç, tha se pajtohem me propozimin e z. Marolli.

Triera Kasumi - Berisha, tha se, meqë ne i kemi krijuar komisionet, e në komisionin për shkolla jam unë, dhe kemi bërë një identifikim të nxënësve të komuniteteve jo shumicë të cilët vijojnë mësimin në shkollat e Prishtinës.

Ajo mes tjerash tha se me anë të kontrollit të dhënavë si dhe mekanizmave të tjera mundemi me parandaluar çdo lloj anashkalimi dhe shkelje të drejtave.

Klaudia Mula, propozoi që të krijohet një komision nga anëtarët e komitetit dhe të ZKKK-së, që të mbahet një takim me zyrën për çështje të komuniteteve pranë Kryeministrat dhe të shqyrtohen të gjitha problemet që na shqetësojnë në nivel lokal.

Mirsada Behluli, kryesuese, për anëtarë të komisionit propozoi Nenad Miladinoviç, Triera Kasumi - Berisha dhe nga ZKKK-ja, Klaudia Mula.

Nenad Miladinovic, tha se sa i përket sigurisë tek komuniteti serb nuk kemi probleme, problemin që e kemi pasur më kanalizimin e kemi zgjedhur, mirëpo kemi një problem që një vit e gjysmë që ka të bëjë më usurpimin e pronës shoqërore komunale nga disa njerëz të cilët nuk e di se nga vijnë, por mund të them se rrezikojnë dhe pengojnë punën në pronën private të njerëzve të cilët jetojnë aty.

Pika e gjashtë Të ndryshme

Mirsada Behluli, kryesuese, i informoi të pranishmit lidhur me një mesazh që ka marrë nga FSK-ja, e cila tha se në muajin shtator planifikojnë të hapin konkurse për rekrutë të rinj për 612 pozita, prandaj të gjithë të rinjtë e interesuar nga komunitetet jo shumicë të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e FSK-së, duhet të fillojnë më përgatitjet për testin fizik, pastaj vjen testi i inteligjencës dhe testi i njohurive të përgjithshme. Për më tepër mund të informoheni përmes WEB faqes së Ministrisë së Mbrojtjes.

Triera Kasumi - Berisha, propozoi që nëse kishte pasur mundësi që Komiteti për Komunitete, me e krijuar një linjë të komunikimit publik për të gjitha komunitetet, e kishim lehtësuar edhe punën e komunikimit të anëtarëve që i kemi brenda komitetit, pra me e krijuar një mekanizëm të përgjithshëm të informimit për krejt punët që dalin nga komiteti, pasi që brenda portalit të Komunës së Prishtinës ne kemi vetëm raporte të cilat janë të formatit të njëjtë, edhe nuk ka informacione të përditësuara.

Mirsada Behluli, kryesuese, tha së për krijimin e linjës së komunikimit publik për anëtarët e komuniteteve brenda komitetit, propozoi që të formohet një grup në viber që kishim mundur më komunikuar dhe më qenë më efektiv në punë dhe me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e komitetit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve të dhëna, Komiteti për Komunitete nxori këto

R E K O M A N D I M E:

1. Të ftohet Kryesuesi i Kuvendit z. Fehmi Kupina;
2. Vizitë në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë;
3. Të ftohet drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë - Musmurati;
4. Të dorëzohet lista e familjeve të cilat kanë nevojë për dru zjarri.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Dr. Mirsada Behluli

